



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:272428

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06854003

Ac.nr.1392/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Fatmir Baloku, kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë F. G., avokat në Prishtinë dhe A. B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, për kompensimin mbi bazën e kualifikimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1985/21, të datës 20.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., që të gjithë nga Gjakova, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1985/21, i datës 20.12.2022, dhe çështja gjykohet si në vijim: - APROVOHET pjesërisht si e themeltë kërkesëpadia e paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës– Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, që në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit për periudhën kohore nga dt.01.12.2018 deri me dt.31.01.2021 (gjithsejtë 26 muaj), paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses M. B. shumën prej 1,439.10 euro;
- Paditësit Sh. J. shumën prej 1,439.10 euro;
- Paditësit I. Z. shumën prej 1,439.10 euro;
- Paditëses L. D. shumën prej 1,439.10 euro;
- Paditësit F. S. shumën prej 1,439.10 euro; të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (01.12.2021), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 332 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmarimit me detyrim.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për periudhën nga data dt.08.10.2018 deri me dt.30.11.2018
SI E PA BAZUAR.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1985/21, të datës 20.12.2022, ka vendosur si vijon: I. REFUZOHET në tërësi, kërkesëpadija e paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S. që të gjithë nga Gjakova, me të cilën kanë kërkuar që të, “Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, të iu njoh: -Paditëses M. B., në emër të kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë prej 27% të pagës bazë për 28 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021 të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, -Paditësit Sh. J., në emër të kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë prej 27% të pagës bazë për 28 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021 të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, -Paditësit I. Z., në emër të kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë prej 27% të pagës bazë për 28 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021 të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, -Paditëses L. D., në emër të kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë prej 27% të pagës bazë për 28 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021 të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, -Paditësit F. S., në emër të kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë prej 27% të pagës bazë për 28 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021 të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga data e parashtrimit të kërkesës pranë të paditurës, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, si e pabazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësve, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e paditësve ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditësve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., që të gjithë nga Gjakova, që të gjithë nga Gjakova, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.01.12.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, për kompensimin mbi bazën e kualifikimit, me detaje të përshkruara si në padi, të precizuara sipas parashtresës së datës 22.11.2022.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 399 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadija

është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozite ligjore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1985/21, të datës 20.12.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: gjykata marrë parasysh kërkesën e paditësve, e po ashtu duke analizuar Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, në veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësja pretendon se i takon e drejta e kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, e ku kjo dispozitë përcakton se “me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shikim nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% të pagës bazë”, erdhi në përfundim se kërkesa e tyre është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim: Për gjykatën nuk ishte kontestuese që dispozitat e lartcekura kanë përcaktuar kompensimin për diferencën në pagë, mirëpo gjykata vlerëson se kjo dispozitë nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit, por që nga interpretimi i dispozitës se lartcekur shihet qartë që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar e assesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate [RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PAGAT], ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu që nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të të paditurës: kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga Enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të KKAK-së, për çka gjykata e morri si të bazuar pretendimin e të paditurës për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se “Pagat e punëtoreve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.”, andaj gjykata në rastin konkret nuk gjeti se me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara. Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, përpos që është përshkruar procedura e aplikimit për sistemin e licencimit dhe zhvillimit në karrierë të mësimdhënësve, janë listuar edhe akterët kryesor në zbatimin e këtij sistemi si dhe janë përcaktuar punët dhe detyrat e tyre, ashtu që në asnjërin prej tyre nuk parashihet obligimi taksativ për të ngritur pagat në shkallën siç është përcaktuar në nenin 7 të KKAK-së. Si rrjedhojë, nuk ka raport kontraktual në mes të palëve ndërgjyqëse apo dispozitë të karakterit obligativ që krijon të drejtën për paditësit e cila do të krijonte detyrimin për të paditurën që të kompensonte të njëjtit për këtë kriter të kompensimit, (me decidivisht si në arsyetim të këtij aktgjykimi). Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 399 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitat e nenit 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, përcaktohet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë. 1.4 Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë. 1.5 Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10%”*. Në nenin 33 par.1 pika 1.1. të UA për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë thuhet se: *“vazhdohen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014...”*.

Po ashtu, me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në pikën 4 është përcaktuar se: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë, te pajisur: 1) Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %, 2) Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %, 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %”*, e të cilin vendim e ka mbështetur edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (*mendimi juridik lidhur me kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) për kompensim sipas inflacionit dhe periudha kohore në të cilën zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, nr.105 datë 22.01.2021, par. I*), ku parashihet se: *“Për kërkesat e mësimdhënësve mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.*

Këto dispozita përcaktojnë të drejtën e punëtorit për kompensimin mbi bazën e kualifikimit, mirëpo në rastin konkret themelësia e kërkesëpadisë së paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S. për periudhën nga data 08.10.2018-30.11.2018, nuk mund të mbështetet në këto dispozita, për shkak se kërkesa për këtë periudhë është parashkruar dhe prapësimin e parashkrimit e ka paraqitur e paditura me rastin e dhënies së përgjigjes në padi.

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar pretendimin e të paditurës për parashkrim, gjen se në këtë çështje juridike kontestuese kërkesa e paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., për kompensimin mbi bazën e kualifikimit, pjesërisht është parashkruar dhe atë për periudhën nga data 08.10.2018-30.11.2018, për çka vendosi që ta refuzoj si të pabazuar këtë pjesë të kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se: *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Andaj, referuar kësaj dispozite ligjore, paditësve me të drejtë ju refuzohet pjesërisht kërkesëpadia për shkak të parashkrimit, duke marrë parasysh faktin se paditësit padinë e kanë ushtruar në gjykatë me datë 01.12.2021 dhe kanë kërkuar kompensimin mbi bazën e kualifikimit për periudhën nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021, çka nënkupton që kërkesa e paditësve për periudhën nga data 08.10.2018-30.11.2018, është parashkruar, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, duke ju referuar dispozitave ligjore të lartcekura, vlerëson se paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., sa i përket periudhës nga data 01.12.2018 deri me datë 31.01.2021 (gjithsejtë 26 muaj), ju takon e drejta në kompensim mbi bazën e kualifikimit, pasi që sipas shkresave të lëndës rezulton se paditësja M. B. është e pajisur me diplomë përkatëse dhe atë diplomën me nr...., të datës 24.03.2015, me titull “Bachelor i Programit Fillor”, dhe nga lista e pagave me nr.EM..., rezulton se paditësja pagën bazë e ka në shumën prej 421 euro dhe se të njëjtës në emër të kualifikimit sipas listës së pagave i paguhet shuma prej 58.32 euro si dhe nga Licenca e mësimdhënësit e lëshuar nga MASHT, me nr...., vërtetohet se paditësja ka licencë të rregullt, me lloj të licencës së karrierës nga data 26.12.2012. Paditësi Sh. J. është i pajisur me diplomë përkatëse dhe atë diplomën me nr...., të datës 03.12.2012, me titull “Profesor i Filozofisë-Sociologjisë”, dhe nga lista e pagave me nr.EM..., rezulton se paditësi pagën bazë e ka në shumën prej 421 euro dhe se të njëjtës në emër të kualifikimit sipas listës së pagave i paguhet shuma prej 58.32 euro si dhe nga Licenca e mësimdhënësit e lëshuar nga MASHT, me nr...., vërtetohet se paditësi ka licencë të rregullt, me lloj të licencës së karrierës nga data 18.07.2014. Paditësi I. Z. është i pajisur me diplomë përkatëse dhe atë diplomën me nr..., të datës 28.10.2015, me titull “Bachelor i Programit Fillor”, dhe nga lista e pagave me nr.EM..., rezulton se paditësi pagën bazë e ka në shumën prej 421 euro dhe se të njëjtës në emër të kualifikimit sipas listës së pagave i paguhet shuma prej 58.32 euro si dhe nga Licenca e mësimdhënësit e lëshuar nga MASHT, me nr...., vërtetohet se paditësi ka licencë të rregullt, me lloj të licencës së karrierës. Paditësja L. D. është e pajisur me diplomë përkatëse dhe atë diplomën me nr..., të datës 18.03.2015, me titull “Bachelor i Programit Parashkollor”, dhe nga lista e pagave me nr.EM..., rezulton se paditësja pagën bazë e ka në shumën prej 421 euro dhe se të njëjtës në emër të kualifikimit sipas listës së pagave i paguhet shuma prej 58.32 euro si dhe nga Licenca e mësimdhënësit e lëshuar nga MASHT, me nr...., vërtetohet se paditësja ka licencë të rregullt, me lloj të licencës së karrierës nga data 26.12.2012. Paditësi F. S. është i pajisur me diplomë përkatëse dhe atë diplomën me nr...., të datës 16.02.2012, me titull “Bachelor i Programit Fillor”, dhe nga lista e pagave me nr.EM..., rezulton se paditësi pagën bazë e ka në shumën prej 421 euro dhe se të njëjtës në emër të kualifikimit sipas listës së pagave i paguhet shuma prej 58.32 euro si dhe nga Licenca e mësimdhënësit e lëshuar nga MASHT, me nr...., vërtetohet se paditësi ka licencë të rregullt, me lloj të licencës së karrierës nga data 26.12.2012, çka nënkupton se për periudhën kohore nga data 01.12.2018 deri me datë 31.01.2021 (gjithsejtë 26 muaj), paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., në bazë të kualifikimit ju takon secilit 27 % i pagës bazë, apo shuma për secilin paditës në vlerë prej 1,439.10euro ($421 * 27\% = 113.67 - 58.32 = 55.35 * 26 \text{ muaj} = 1,439.10 \text{ euro}$), andaj edhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoj se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko-civil, ndaj paditësve M. B., Sh. J., I. Z., L. D. dhe F. S., në emër të pagesës për kompensimin mbi bazën e kualifikimit në shumën e gjykuar, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vendimin për kamatën ligjore e ka bazuar në dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së si dhe Mendimit Juridik për kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 02.12.2020.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452, 453.2 dhe 463.1 të LPK-së dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 332.00 euro.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.1392/23, me datë 13.02.2025

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v